

Pyetje dhe përgjigje lidhur me funksionimin e Programit të Kuponëve

1. Si funksionon Programi i Kuponave?
 - Programi i Kuponave mbështet edukimin në fëmijërinë e hershme për fëmijët të cilët janë përfitues të Skemës për Asistencë Sociale.
2. Kush mund të përfitoj nga Programi i Kuponave?
 - Për t'u kualifikuar si përfitues nga Programi i Kuponave, aplikuesit duhet ti plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - Familjet e tyre duhet të jenë të regjistruara në SAS si përfitues;
 - Të kenë të paktën një fëmijë të moshës nga 3 deri në 5 vjeç në kohën e regjistrimit në institucion parashkollor;
 - Fëmija duhet të ketë vendbanimin në komunën ku aplikon për të vijuar edukimin.
3. Si realizohet procedura e aplikimit për përfituesit?
 - Procedura e aplikimit realizohet nëpërmjet e-Kosova, tek faqja Arsimi, Regjistrimi i Institucioneve Parashkollore Private për programin e Kuponave <https://ekosova.rks-gov.net/Service/5>
4. Nga kush duhet të realizohen aplikimet në emër të fëmijës ?
 - Aplikimet mund të realizohen vetëm nga prindërit dhe kujdestarët ligjorë.
5. Sa duhet të jetë mosha e fëmijës në momentin e aplikimit?
 - Mosha e fëmijës llogaritet nga data e ofrimit të shërbimit në institucionin parashkollor, jo nga data e aplikimit në Program. Rrjedhimisht prindi apo kujdestari ligjor mund të aplikoj edhe para se fëmija të ketë mbushur moshën 3 vjeç apo 5 vjeç, duke filluar 2 vjet e 6 muaj deri në moshën 4 vjet e 6 muaj. Me kusht që vijimi në institucion parashkollor ta nis në moshën 3 vjeçare dhe ta përfundoj kur fëmija fillon edukimin e detyrueshëm parafillor pas moshës 5 vjeçare.
6. A mbulohet transporti i fëmijës deri në institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme?
 - Programi i Kuponave do të mbulojë koston e transportit për fëmijët të cilët nuk janë në gjendje të udhëtojnë të sigurt për në institucionin parashkollor, të shoqëruar nga prindërit ose kujdestari i tyre ligjor të cilët banojnë 4 kilometra më larg se institucioni më i afërt parashkollor. Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave vlerëson shkaqet e arsyshme për transport sipas nevojës si dhe përmbushjen e kriterit të distancës rrugore.

7. Cili është roli i Institucioneve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (IEFH)?
- IEFH pjesëmarrëse në program do të rimbursohen nga MASHTI për shërbimet e edukimit të ofruara për fëmijët përfitues të programit. Përveç pagesës së shërbimit të edukimit, MASHTI do të mbështes edhe pagesën për transportin e fëmijës, për IEFH të cilat ofrojnë transport. IEFH-të e verifikuara për të qenë pjesë e programit do ti bashkangjesin të dhënat e tyre në procedurë të aplikimit dhe në momentin e regjistrimit të fëmijës ata do ti ndjekin procedurat të cilat parashihen me Ligjin Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme.
8. Cilat janë kriteret për regjistrimin e IEFH në program?
- Të jenë të licencuara dhe të posedojnë vende të lira për regjistrimin e fëmijëve të cilët janë përfitues të programit.
9. Si mund të regjistrohet IEFH për të qenë pjesëmarrëse në Program të Kuponave?
- Të gjitha IEFH të licencuara duhet të regjistrohen përmes sistemit të e-Kosovatek faqja Arsimit, Regjistrimi i Institucioneve Parashkollore Private për programin e Kuponave <https://ekosova.rks-gov.net/Service/5> duke e shprehur interesin e tyre për pjesëmarrje në program. Procesi i regjistrimit të Institucioneve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme hapet 1 herë në vit dhe mbetet i hapur për një periudhë prej 15 ditësh. Regjistrimi i tyre do të vërtetohet brenda një periudhe prej 15 ditëve nëpërmjet departamentit përgjegjës për licensimin e IEFH, Divizionit për Arsim Parauniversitar Privat të MASHTI.
10. Cilat janë përgjegjësitë e IEFH pjesëmarrëse në program?
- Përgjegjësitë e IEFH përfshijnë;
 - Zyrtari i regjistrimit nga IEFH do të verifikojë të dhënat e fëmijës. Informacionet që duhet verifikuar janë: a) të dhënat e imunizimit/vaksinimit, alergjitë ose nevoja të veçanta ushqimore dhe shëndetësore, përfshirë edhe dëshminë nga mjeku për gjendjen e përgjithshme të fëmijës; dhe b) informacionin e kontaktit të prindit/kujdestarit ligjorë.
 - IEFH-të do të raportojnë nëpërmjet e-Kosova lidhur me vijueshmërinë e fëmijëve.
 - IEFH pjesëmarrëse në Programin e Kuponave do t'i nënshtrohen procedurës së monitorimit dhe vlerësimit nga a) MASHTI, b) Drejtoria Komunale e Arsimit, dhe c) Mekanizmi i Pavarur për Verifikim.